

VENDIM
Nr. 646, datë 3.8.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN
E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE, TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT), NË
BASHKITË LEZHË, DURRËS DHE SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 331 094 921 (treqind e tridhjetë e një milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, dëmtime të rënda apo të lehta, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë, Durrës dhe Shijak.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi në masën 73 050 000 (shtatëdhjetë e tre milionë e pesëdhjetë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 136 950 000 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para.

c) Bashkisë Shijak i transferohet fondi prej 121 094 921 (njëqind e njëzet e një milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale, për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime riforcimi.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Lezhë, Durrës dhe Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe